




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 523 /18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Blerim Dina– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković, - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Biti Com” - Podujevë kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku i rekomanduar për dhënie të kontratës është OE “Lulishtja Buçaj” Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616/18/317/111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë, më datën 24.10.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Biti Com” – Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616/18/317/111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616/18/317/111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “**Biti Com**” – **Podujevë** refuzohet si e pabazuar, i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: **31.01.2018**

Hapja e ofertave është bërë me dt: 07.03.2018

Kundër njoftimit për anulim të aktivitet të prokurimit, operatori ekonomik “**Biti Com**” - **Podujevë** me dt: 13.09.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 17.09.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “**Biti Com**” - **Podujevë** si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues: “**Biti Com**” - **Podujevë** si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 27.09.2018 me nr. 523 / 18, kundër njoftimit për anulim të aktivitete të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me drunjë dekorativ në hapësirat dhe parqet e qytetit të Prishtinës” me nr. të prokurimit: 616/18/317/111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë duke pretenduar se janë shkelur dispozitat.

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7,59,60,69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: **01.10.2018** ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 11.10.2018, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues: “**Biti Com**” - **Podujevë** në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:
Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues – KK Prishtinë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar Procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, kontratë publike me vlerë të mesme, operatori ekonomik ankues: N.T “**Biti Com**” – **Podujevë**, ka parashtruar ankesë kundër njoftimit për eliminim.

Fillimisht duhet te theksoj se kjo çështje është shqyrtuar dy herë më parë nga ana e OSHP-së dhe lidhur me këtë çështje janë marrë dy vendime nga ana e OSHP-së, vendimi Psh.nr.137/18 i datës 15.05.2018, si dhe vendimi Psh.nr.255/18 i datës 24.08.2018.

Në përgjigje të pretendimeve ankimore të OE:”Biti Com”, me gjiha dispozitat e përmendura në ankesën e OE ankues si pretendim se jane shkelur nga ana e AK-së, thelbi dhe i gjithë kontesti në këtë procedurw lidhet me kërkesën e AK-së tek kapaciteti teknik dhe profesional, dhe faktin se a është plotësuar kjo kërkesë nga ana e OE:”Biti Com”.

Kërkesa e AK-së te kapaciteti teknik dhe profesional si dëshmi dokumentare ka kërkuar certifikatë fitosanitare.

OE:”Biti Com” për këtë kërkesë si dëshmi ka ofruar një certifikatë fitosanitare të datës 27 Shkurt 2018 nga shteti i Holandës.

Në këtë certifikatë në pikën 8 gjendet hapësira ku shënohen: vetitë dalluese, numri dhe përshkrimi i pakos, emri i prodhimit dhe emri botanik i bimës. Ndërsa në pikën 9 të certifikatës duhet shënuar sasia. Në këtë hapësirë produkti me numër rendor 0001 (njëkohësisht produkti i vetëm në këtë certifikatë), emri i produktit mban përshkrimin “potting substrate”, që në shqip është “Substrat për vazo” apo “Dhe për vazo”. Në këtë hapësirë nuk ka ndonjë produkt tjetër apo përshkrim tjetër të produktit. Në pikën 9 shënon sasia 4 paleta.

Me këtë vlerësoj se dëshmia e ofruar prej OE ankues nuk është konform kërkesës së AK-së.

AK ka kërkuar certifikatë fitosanitare në një aktivitet të prokurimit për furnizim me drunjë dekorativ, ndërsa OE ankues në këtë rast ka ofruar si dëshmi për kapacitet teknik dhe profesional certifikatë për Substrat apo Dhe për mbiellie në vazo.

Me këtë gjendje faktike, duke u bazuar gjithnjë në kërkesën e vet AK-së, OE ankues i përshtatshëm në kuptim të nenit 51 të LPP-së.

OE ankues me ankesën e dorëzuar në OSHP, e po ashtu edhe në sqarime me AK-në, ka ofruar edhe certifikata tjera fitosanitare, mirëpo këto certifikata nuk kanë qenë pjesë e ofertës origjinale të OE “Biti Com” dhe nuk mund të zëvendësohen me certifikatën e dorëzuar në dosje para hapjes së ofertave.

OE ankues në ankesë po ashtu potencon raportin e ekspertizës parprake lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ku eksperti në atë rast ka vlerësuar se certifikata e OE:”Biti Com” e plotëson kërkesën e AK-së. Këtë konstatim eksperti në seancë për shqyrtim kryesor e bazon në pikën 10 të certifikatës në fjalë.

Duhet të sqaroj se këtu eksperti gabimisht i është referuar kësaj pike, sepse pika 10 e certifikatës vetëm jep informata se inspektimi dhe testet janë bërë konfrom procedurave të duhura zyrtare dhe nuk përmban

informata se çfarë bime apo çfarë produkti i është nënshtruar këtij inspektimi. Kjo informatë siç potencova më lart është dhënë në pikën 8 të certifikatës.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar (për arsyet që u çekën tek përgjigjet në pretendimet ankimore), dhe njëkohësisht të vërtetohet si i bazuar vendimi i AK-së për dhënie të kontratës.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 15.10.2018 ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore që është mbajtur me datën: 24.10.2018, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të OSHP-së dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues teknik, deklaramentit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se kjo çështje është shqyrtuar dy herë më parë nga ana e OSHP-së dhe lidhur me këtë çështje janë marrë dy vendime nga ana e OSHP-së, vendimi Psh.nr.137/18 i datës 15.05.2018, si dhe vendimi Psh.nr.255/18 i datës 24.08.2018.

Paneli shqyrtues konstaton se OE: "Biti Com" Podujevë pretendon se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave respektivisht ofertës se tij nuk është bërë në mënyrë të drejtë duke pretenduar se ky operator ekonomik e plotëson kërkesën e autoritetit kontraktues tek kapaciteti teknik dhe profesional, ku AK-ja ka kërkuar certifikatë fitosanitare. Paneli shqyrtues konstaton se OE: "Biti Com" për këtë kërkesë si dëshmi ka ofruar një certifikatë fitosanitare të datës 27 Shkurt 2018 nga shteti i Holandës. Në këtë certifikatë në pikën 8 gjendet hapësira ku shënohen: vetitë dalluese, numri dhe përshkrimi i pakos, emri i prodhimit dhe emri botanik i bimës. Ndërsa në pikën 9 të certifikatës duhet shënuar sasia. Në këtë hapësirë produkti me numër rendor 0001 (njëkohësisht produkti i vetëm në këtë certifikatë), emri i produktit mban përshkrimin "potting substrate", që në shqip është "Substrat për vazo" apo "Dhe për vazo". Në këtë hapësirë nuk ka ndonjë produkt tjetër apo përshkrim tjetër të produktit. Në pikën 9 shënon sasia 4 paleta.

Paneli shqyrtues duke i nisur nga sqarimet e dhëna si me lart konstaton se vlerësimi i ofertës së OE ankues është bërë në pajtim me nenin 59 të LPP-së për faktin se dëshmia e ofruar prej OE ankues nuk është konform kërkesës së AK-së dhe me të drejti i njëjti operator ekonomik është shpallur i pa përgjegjshëm nga ana e AK-së.

Paneli shqyrtues sqaron se AK ka kërkuar certifikatë fitosanitare në këtë aktivitet të prokurimit për furnizim me drunjë dekorativ, ndërsa OE ankues në këtë rast ka ofruar si dëshmi për kapacitet teknik dhe profesional certifikatë për Substrat apo Dhe për mbiellie në vazo.

Andaj duke u bazuar në këtë fakt si dhe duke pasur parasysh kërkesën e AK-së për këtë pike konstatohet se OE ankues nuk është përshtatshëm në kuptim të nenit 51 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konstaton se OE ankues me ankesën e dorëzuar në OSHP, e po ashtu edhe në sqarime me AK-në, ka ofruar edhe certifikata tjera fitosanitare, mirëpo këto certifikata nuk kanë qenë pjesë e ofertës origjinale të OE "Biti Com" dhe nuk mund të zëvendësohen me certifikatën e dorëzuar në dosje para hapjes së ofertave.

Sa i përket pretendimit të OE ankues ku në ankesën e tij potencon raportin e ekspertizës paraprake lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ku eksperti në atë rast ka vlerësuar se certifikata e OE: "Biti Com" e plotëson kërkesën e AK-së. Këtë konstatim eksperti në seancë për shqyrtim kryesor e bazon në pikën 10 të certifikatës në fjalë. Paneli shqyrtues sqaron se këtu eksperti gabimisht i është referuar kësaj pike, sepse pika 10 e certifikatës vetëm jep informata se inspektimi dhe testet janë bërë konform procedurave të duhura zyrtare dhe nuk përmban informata se çfarë bime apo çfarë produkti i është nënshtruar këtij inspektimi. Kjo informatë është dhënë në pikën 8 të certifikatës.

Paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron pretendimi i ankuesit për shkelje të dispozitave të LPP-së, sepse vlerësimi ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave për aktivitetin e prokurimit në fjalë është bërë në pajtim me nenin 59 të LPP-së dhe nuk shihet ndonjë diskriminim apo favorizim i OE –ve pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit në fjalë, po ashtu vlerësimi është bërë në baze të kërkesave të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Gjithashtu, Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka pasur në

konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK-Prishtinë

1x1 OE- “Biti Com” - Podujevë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.